

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 8, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 11<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 183/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 144-b paragrafi (8) nga Ligji i njëjtë, në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) nënparagrafi 7 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 11 të Rregullores së Punës të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019 në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.02-245/3 datë 22.01.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e dytë mbajtur më 21.01.2025 miratoi:

## **RREGULLORE**

### **për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove**

#### **Neni 1**

#### **Lënda e Rregullores**

Me këtë Rregullore, rregullohet forma dhe përmbajtja e formularit të fletëparaqitjes dhe Regjistrimit të ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove, e cila udhëhiqet nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

#### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

(1) Disa shprehje të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. Shërbimi platformë për ndarjen e videove është shërbim i shoqërisë së informacionit, destinuar për publikun e gjerë dhe ofrohet nëpërmjet rrjetit të komunikimit elektronik, ku qëllimi parësor dhe/ose funksionaliteti bazë në tërësi dhe/ose në pjesën e tij të veçantë është t'i ofron publikut qasje në programe dhe/ose video të krijuara nga përdorues që kanë funksion informues, edukativ ose argëtues, për të cilin ofruesi i shërbimit nuk ka përgjegjësi redaktuese për përmbajtjen, por vetëm përcakton mënyrën se si është

---

<sup>1</sup>Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

organizuar shërbimi, duke përfshirë këtu edhe mjete automatike ose algoritme, veçanërisht duke shfaqur, shënuar ose renditur përmbajtjen;

2. Video e krijuar nga përdorues është tërësi figurash (imazhesh) lëvizëse, me ose pa zë, pavarësisht nga kohëzgjatja, që paraqet element të veçantë, i krijuar nga përdorues dhe i ngarkuar në platformë për ndarjen e videove nga ai ose përdorues tjetër.
3. Ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove është person fizik ose juridik që ofron shërbim të platformës për ndarjen e videove.

## **I. FORMA DHE PËRMBAJTJA E FLETËPARAQITJES PËR EVIDENCË NË REGJISTRIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZUELE ME KËRKESË.**

### **Neni 3 Detyrimi për evidencë**

- (1) Ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove, i cili është nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është i detyruar para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, të paraqesë kërkesë për evidentim në Regjistrin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove e cila udhëhiqet nga Agjencia, nga ku Agjencia jep çertifikatë për regjistrim.
- (2) Ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove, është i detyruar të njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave të paraqitura në fletëparaqitjen në afat prej 30 ditësh nga dita e ndryshimit të kryer. Agjencia është e detyruar të shënojë ndryshimin e të dhënave në Regjistër në afat prej tre ditë pune nga dita e pranimit të njoftimit.

### **Neni 4 Forma dhe përmbajtje e Fletëparaqitjes**

- (1) Fletëparaqitje për evidencë në Regjistrin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove paraqitet në Agjenci në Formularin bashkëngjitur kësaj rregulloreje si Shojcë I.
- (2) Fletëparaqitja duhet të përmbajë të dhëna për:
  - emri i plotë i personit juridik
  - selia e personit juridik
  - numri amzë i identifikimit të subjektit
  - të dhënat për personin përgjegjës (emri, mbiemri dhe adresa);
  - emri i platformës për ndarjen e videove;
  - adresa e shërbimit të internetit (URL);

- karakteristikat e detajuara teknike për mënyrën e ofrimit të shërbimit;
- llojin e shërbimit dhe përshkrim të shkurtër të tij;
- të dhëna për adresën elektronike që mundëson kontakt të drejtpërdrejtë me ofruesin e shërbimit dhe personin përgjegjës;
- data e fillimit të ofrimit të shërbimit.

(3) Me fletëparaqitjen detyrimisht duhet të dorëzohet përshkrim teknik me karakteristika teknike të detajuara për mënyrën në të cilën do të ofrohet shërbimi.

(4) Agjencia do t'i përdorë të dhënat e paraqitura vetëm për nevojën për të cilën janë mbledhur, në pajtim me „Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale“.

### **Neni 5**

#### **Regjistri i ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove**

Regjistri i ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove përmban të dhënat e mëposhtme:

- Emri i plotë i personit juridik
- Selia e personit juridik
- Personi përgjegjës
- Të dhëna për pronarin
- Emri i platformës për ndarjen e videove
- Adresa elektronike e personit përgjegjës dhe juridik

## **II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 6**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI**

**SHTOJCË I**

**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE  
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**Pallati Panko Brashnarov,  
rr.„Makedonija“ nr.38, 1000 Shkup,  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
Tel: +389 23 103 400  
Faks: +389 23 103 401**

--

(vula pranuese e ASHMA-së)

**FLETËPARAQITJE**

**Për evidentimin në Regjistrin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove**

**1 TË DHËNA PËR OFRUESIN E SHËRBIMIT**

Emri i plotë i personit juridik	
Selia e personit juridik	
NVAS	
Personi përgjegjës	
Adresa e personit përgjegjës	
Adresa elektronike e personit juridik	
Adresa elektronike e personit përgjegjës	
Telefon për kontakt	

**2. Detaje për platformën**

Emri i platformës për ndarjen e videove	
Adresë interneti (URL) të shërbimit	
Përshkrim i shkurtër të shërbimit	
Data e fillimit të ofrimit të shërbimit	

**3. SHTOJCA NDAJ FLETËPARAQITJES:**

- 3.1. Përshkrim teknik me karakteristika teknike të detajuara për mënyrën se si do të ofrohet shërbimi;
- 3.2. Gjendja vijuese nga Regjistri Qendror.